



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr.1183/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të Nuhi Paçarizi - Kryetar, Blerim Dina - Referues, Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik “MARISA” SHPK & “Company Murseli” SHPK- Gjakovë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë OE “SELMAN NETWORK” SHPK -Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i parkingjeve dhe stacioneve te autobusëve” me nr. të prokurimit: 632-20-7006-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KK GJAKOVË, më datën: 01.02.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. **APROVOHET**, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik OE “MARISA” SHPK & “Company Murseli” SHPK- Gjakovë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i parkingjeve dhe stacioneve te autobusëve” me nr. të prokurimit: 632-20-7006-5-2-1, iniciuar nga AK)– KK GJAKOVË.

II. **ANULOHET**, njoftimi për dhënie të kontratës lidhur aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i parkingjeve dhe stacioneve te autobusëve” me nr. të prokurimit: 632-20-7006-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KK GJAKOVË, dhe lënda të kthehet në **rivlerësim**.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik “MARISA” SHPK & “Company Murseli” SHPK- Gjakovë, aprovohet si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimin të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Operatori ekonomik “MARISA” SHPK & “Company Murseli” SHPK- Gjakovë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me dt: 31.12.2020 me nr. 1183/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i parkingjeve dhe stacioneve të autobusëve” me nr. të prokurimit: 632-20-7006-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KK GJAKOVË, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 6, 7, 56, 59, 60, 69 dhe 72 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 06.01.2021, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 15.01.2021, lidhur me pretendimin ankimor të OE ankues sqaron si në vijim:

Pretendimi nr. 1

Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues është eliminuar nga ky aktivitet i prokurimit me arsyetimin se: Si operator ekonomik, ne hapje të ofertave ju keni ofertuar si operator i vetëm Marisa Shpk ndërsa keni dorëzuar dokumentacion edhe të OE Company Murseli.

Gjate shikimit të dokumentacionit rezulton se nuk i keni prezantuar ISO standardet 9001:2015 dhe 14001:2015 dhe nuk e plotësoni kërkesën për kontrata dhe referenca sipas kërkesës së DT-se.

Eksperti shqyrtues, sa i përket arsyes se pare të eliminimit sqaron se nuk qëndron arsyetimi i AK-se, për laktin se OE ankues ne ofertën e tij i ka dorëzuar marrëveshjet e konzorciumit të parapara në nenin 71 të LPP- se. Prandaj ky arsyetim i dhënë nga AK-ja, nuk qëndron.

Sa i përket arsyes dyte të eliminimit që ka të bëjë me certifikatat ISO 9001:2015 dhe 14001:2015, eksperti shqyrtues, sqaron se ne ofertën e tij nuk i ka dorëzuar certifikatat e lartpërmendura të cilat kanë qenë kërkesë e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Lidhur me arsyen e trete të eliminimit, që ka të bëjë me listën e kontratave, eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues nuk e ka dorëzuar listën e kontratave, andaj sipas dispozitave të nenit 39 të RrUOPP-se, konkretisht

tabelës se dhënë, ne piken e dyte te saj, thuhet se për mungesë te listës se kontratave tenderit duhet te refuzohet pa kërkuar informacion te mëtejme. Prandaj, eksperti shqyrtues, vlerëson se AK-ja ne ketë rast ka vepruar ne harmoni me dispozitat e LPP-se dhe legjislacionit sekondar dhe njeherit sqaroj se pas ekzaminimit te kontratave dhe referencave OE ankues nuk ka dorëzuar kontrate të natyrës së ngjashme për furnizim dhe vendosje të kabinave të ngjashme.

Ne vazhdim eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues ka pretendime se i rekomanduari për kontrate nuk e plotëson kërkesën për kontrata dhe referenca, me arsyetimin se i njëjti nuk ka dorëzuar fare kontrate për referencën e dorëzuar ne ofertën e tij. Eksperti shqyrtues sqaron se nuk ka qene kërkesë e DT-se, qe te dorëzohen kontratat por vetëm lista e kontratave dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje të punëve - furnizim dhe vendosje të kabinave të ngjashme.

Ne rastin konkret OE i rekomanduar për kontrate e ka dorëzuar referencën me titull: Ndërtimi i 16 nënstacioneve te autobusëve ne Komunën e Suharekës dhe e njëjta reference gjendet edhe ne listën e kontratave, pasi qe ne dosje te tenderit është kërkuar qe OE duhet te dëshmojë se ka përfunduar se paku një kontrate. Andaj, ky pretendim i OE ankues nuk qëndron.

Lidhur me pretendimin e OE ankues, se i rekomanduari për kontrate për veprimtari ka kryesisht mirëmbajtjen dhe pastrimin e objekteve, eksperti shqyrtues, sqaron se ne dosje te tenderit AK-ja, nuk ka kërkuar veprimtari adekuate, konkretisht kodin e veprimtarisë. Prandaj, eksperti shqyrtues sqaron se nuk qëndron ky pretendim.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues te aprovohet si pjesërisht e bazuar, ndërsa vendimi i AK-së për dhënie te kontratës te mbetet ne fuqi.

Autoriteti kontraktues me datë 18.01.2021, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori ekonomik me datë 18.01.2021, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Konfirmoj marrjen e ekspertizës

Por nuk pajtohem me mendimin e ekspertit, sepse ka qen skandaloz mendimi i ekspertit

Ku ni ka marr asnjë pretendim për baze edhe pse ka pasur fakte dhe argumente gjithashtu edhe nenin 1 Qellimi.

Kerkojm qe te mbahet seance dhe te ju prezantojmë faktet dhe argumentet tona

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 22.01.2021, nëpërmjet platformës elektronike ZOOM, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues të prokurimit dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankues sqaron se autoriteti kontraktues e ka eliminuar me arsyetimin se në hapje të ofertave ka ofertuar si operator i vetëm Marisa Shpk ndërsa ka dorëzuar dokumentacion edhe të OE Company Murseli, nuk i ka prezantuar certifikatat ISO standarde 9001:2015 dhe 14001:2015, si dhe nuk e plotëson kërkesën për kontrata dhe referenca sipas kërkesës së dosjes së tenderit. Për këto arsye të eliminimit, Paneli Shqyrtues sqaron se OE ankues në ofertën e tij i ka dorëzuar marrëveshjet e konzorciumit të parapara në nenin 71 të LPP- së dhe ky arsyetim i dhënë nga AK-ja nuk qëndron.

Sa i përket arsyes së dytë të eliminimit që ka të bëjë me certifikatat ISO 9001:2015 dhe 14001:2015, Paneli Shqyrtues sqaron se në seancën e mbajtur lidhur me këtë ankesë, OE ankues i ka dorëzuar këto certifikata të cilat janë kërkuar në dosje të tenderit dhe njoftimin për kontratë. Andaj, AK duhet që gjatë ri-vlerësimit ti shqyrtoj këto certifikata.

Lidhur me arsyen e tretë të eliminimit, që ka të bëjë me listën e kontratave, Paneli Shqyrtues sqaron se gjatë shqyrtimit të seancës së mbajtur për këtë ankesë, është sqaruar se OE ankues e posedon listën e kontratave të dorëzuar me tender pranë autoritetit kontraktues.

Në ankesën e parashtruar nga OE ankues, i njëjti ka pretendime edhe kundër OE të rekomanduar për kontratë, se nuk e plotëson kërkesën për kontrata dhe referenca, me arsyetimin se i njëjti nuk ka dorëzuar fare kontratë për referencën e dorëzuar në ofertën e tij. Paneli Shqyrtues sqaron se nuk ka qenë kërkesë e dosjes së tenderit që të dorëzohen kontratat por vetëm lista e kontratave dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje të punëve - furnizim dhe vendosje të kabinave të ngjashme. Në rastin konkret, OE i rekomanduar për kontrate e ka dorëzuar referencën me titull: Ndërtimi i 16 nënstacioneve të autobusëve në Komunën e Suharekës dhe e njëjta reference gjendet edhe në listën e kontratave, pasi që në dosje të tenderit është kërkuar që OE duhet të dëshmojë se ka përfunduar së paku një kontratë. Andaj, ky pretendim i OE ankues nuk qëndron.

Lidhur me pretendimin e OE ankues, se i rekomanduari për kontratë për veprimtari ka kryesisht mirëmbajtjen dhe pastrimin e objekteve, Paneli Shqyrtues sqaron se në dosje të tenderit AK-ja nuk ka

kërkuar veprimtari adekuate, konkretisht kodin e veprimtarisë. Prandaj, nuk qëndron ky pretendim.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, vjen në përfundim se autoriteti kontraktues nuk ka bërë vlerësimin në harmoni të plotë me nenin 59 të LPP-së. Andaj, gjatë rivlerësimit të tenderëve, AK duhet të kërkoj sqarime shtesë konform nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së, të bëjë vlerësimin, ekzaminimin dhe krahasimin e tenderëve në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit dhe nenit 59 të LPP-së. Po ashtu, AK duhet të ketë parasysh edhe nenin 1 dhe 6 të LPP-së pasi që dihet se qëllimi i ligjit është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues
Nuhi PACARIZI



Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK "KK Gjakovë";
- 1x1 OE "Marisa & Company Murseli" SHPK- Gjakovë;
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.